



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2012

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza dhe furnizimit me shumicë me ujë të patrajtuar

Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Kanalizim

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe efçente të ujësjetës dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjetës dhe kanalizimit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”.

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	v
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK	vii
1 Hyrje	1
2 Zhvillimet në sektor	2
Pjesa A	
3 Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit-Kanalizimit	5
3.1 Furnizimi me ujë	5
3.2 Shërbimet për ujëra të zeza	21
3.3 Performanca financiare e KRU	23
3.4 Performanca e përgjithshme e KRU	29
Pjesa B	
4 Performanca e sektorit të shërbimeve të Ujësjellësit-Kanalizimit	36
4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF	36
4.2 Mbulueshmëria me shërbime	37
4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar	38
4.4 Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale)	39
Pjesa C	
5 Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Iber-Iepenci)	42
Pjesa D	
6 Aktivitetet e KKK	44
7 Sfidat për të ardhmën	45
SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës	47
SHTOJCA 2 Definicionet dhe arsyeshmëria	62
SHTOJCA 3 Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave	69
SHTOJCA 5 Pasqyrat tarifore(2012-2014)	72
SHTOJCA 5 Detajet kontaktuese	73
SHTOJCA 6 Zonat e shërbimit të KRU	75

Akronimet dhe shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
BD	Bordi i Drejtorëve
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
PR	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, 'Prishtina' (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, 'Hidroregjioni Jugor' (Prizren)
PE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Hidrodrini' (Pejë)
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, Mitrovica (Mitrovicë)
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, 'Radoniqi' (Gjakovë)
FE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, 'Bifurkacioni' (Ferizaj)
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjellësit, Hidromorava (Gjilanë)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IL	NH 'Ibër Lepenci'
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike
TFU	Taskë Forca e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Fjala hyrëse



Raporti i vlerësimit të performancës për kompanitë e furnizimit me Ujësjellës dhe Kanalizim si dhe Shitjes së Ujit me Shumicë në Kosovë për vitin 2012, është i shtati në një seri raportesh të publikuara nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim.

Monitorimi i Performancës si dhe informimi i publikut për performancën e punës së Ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë, është provuar të jetë një mekanizëm efektiv dhe ka për qëllim që përmes një procesi të vazhdueshëm të ndikoj në përmirësimin e performancës së kompanive dhe njëkohësisht të siguroj konsumatorët, se janë duke marrë përfitimet në shërbime për parat që kanë paguar.

Zyra jonë pra, është një Institucion qëndror me përgjegjësi ligjore, për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuadër të përgjegjësive të saja institucionale. Në këtë drejtim ne jemi të përkushtuar për të qënë të hapur, duke publikuar raporte periodike dhe vjetore, të dhëna statistikore, informacione dhe dokumente të vlefshme për, dhe nga sektori i shërbimeve të ujit. Meqenëse, ne jemi duke vepruar në një sektor i cili është i karakterit monopol fokusi ynë, këtë vit ka qënë më shumë i përkushtuar në aktivitetet rregullatore; në lidhje me tarifatat, standardet e shërbimit si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Aktivitetet tona, po ashtu janë shtrirë edhe në bashkëpunimin e ndërsjellët me institucionet përgjegjëse për adresimin e problemeve siç janë; vendosjen e standardeve të ujit të pijshëm, çështjeve mjedisore, etj. Duke qënë të bindur se ka edhe probleme që rregullimi ekonomik nuk mund të zgjidhin ose të paktën nuk mund të zgjidhin vetëm, siç është rritja e efikasitetit të ofruesve të shërbimeve e cila është ndikuar në masë të madhe nga ai i cili zotëron asetet e ujit, është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve, dhe si pronar ushtron kontroll mbi menaxhmentin e tyre.

Pra, ne kemi punuar me:

- (i) Qeverinë (MZHE, NJPM-NP, TFU, IKSHPK, etj) për të siguruar se aktivitetet e tyre dhe ato rregullatore të janë të nderlidhura me njëra-tjetrën,
- (ii) Të gjitha palët e interesuara përfshirë; Pushtetin Lokal, Agjensionet Zhvillimore Ndërkombëtare (Donatorët), për të parë fushat ku ata mund ti bëjnë investimet e tyre.
- (iii) Menaxhmentin e KRU edhe me konsumatorët, duke ndikuar që sektori të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme financiare dhe operuese si dhe ngritjen e përgjegjësisë së ndërsjellë.

Ne me kënaqësi mund të konstatojmë se Performanca e përgjithshme e KRU, në vitin 2012, është me e përmirësuar në raport me vitin 2011. Përmirësimi është evident në të dyja shërbimet, Furnizim me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza. Sidomos, përmirësimi është më i theksuar tek performanca financiare gjegjësisht profitabiliteti. Megjithatë ne jemi të brengosur për nivelin aktual në eficienten komerciale (Norma e arketimit) e cila shumë pakë është përmirësuar. Në këtë drejtim ne i inkurajojmë, Ofruesit e shërbimeve ujit për tu përballur më me vendosmëri në disa prej treguesve sfiduese, siç janë: Ngritja e dukshme e eficientës së faturimit dhe arkëtimit të borxheve për shërbimin e ofruar, reduktimin e UPF, në norma të pranueshme si dhe realizimi i investimeve të dakorduara gjatë procesit tarifor në përputhje me lartësin dhe shtrirjen kohore.

Performanca e sektorit të shërbimeve të ujit gjatë një periudhe, 4 vjeçare (2009-2012), ka vazhduar të tregojë progresion pozitiv në shumicën e treguesve të performancës e cila edhe është pasqyruar në këtë raport. Një përmirësim i dukshëm është në rritjen e numrit të njerëzve me çasje në furnizimin me ujësjellës. Mbulueshmëria me shërbime nga ujësjellësit publik tani qëndron në nivelin 78%, Megjithatë duhet bërë ende angazhime në këtë drejtim për të përmbushur qëllimin final të mbulimit të tërë popullatës me ujë të pijshëm nga ujësjellësit qëndror. Përderisa mbuleshmëria me shërbime të kanalizimeve është në nivel me të ultë 56%, duke shënuar rritje graduale gjatë kësaj periudhe. Nivel aktual i faturimit të ujit si dhe arkëtimi i faturave ndonese vit pas viti ka përmirësim, niveli prej 70%, është i paknaqshëm dhe paraqet problem serioz për qëndrueshmërinë financiare dhe operative (ruajtjen e bazës së aseteve, zgjerimin e zonës së shërbimit, etj.), të ofruesve të shërbimeve dhe nga ana tjetër mungesës në ngritjen e nivelit të shërbimit për konsumatorët (vazhdimësia e furnizimit, mbrojtja e cilësisë së ujit, etj.). Ne jemi gjithashtu të shqetësuar për mungesën e progresit të Ofruesve të shërbimeve në përmbushjen e objektivave, në reduktimin e UPF. Nuk mund të ketë asnjë dyshim se niveli aktual mesatar prej 58%, është shumë i lartë dhe i pa akceptueshem, duke shkaktuar një deficit të theksuar në mes të ujit të prodhuar dhe kërkesave aktuale për ujë të pijshëm në disa KRU. ZRRUK do të vazhdoj ti mbaj të sfiduara të gjitha kompanitë për premtimet e tyre për ti arritur caqet e dakorduara në këtë fushë.

Ky ka qenë një vit, ku ne konform kompetencave ligjore, jemi angazhuar që konsumatorët të kenë një faturim të saktë të bazuar në leximin e rregullt të ujëmatësave, dhe për këtë ne kemi:

- (i) kërkuar nga KRU, që të gjithë konsumatorët të pajisen me ujëmatësë funksional,
- (ii) aprovuar procedurat dhe listat me mesataret e ngarkesave, për konsumatorët të cilët faturohen në mënyre paushalle deri në vendosjen e ujëmatësës, të cilat janë jo diskriminuese dhe njëkohësisht stimulues për ti shtyrë konsumatorët për ti vendosur ujëmatësës,
- (iii) realizuar inspektime për të konstatuar rregullshmërinë e leximit dhe faturimit dhe për kompanitë të cilat kanë pasur parregullsi kemi shqiptuar gjopa,
- (iv) vendosur që leximi i ujëmatësave të bëhet në baza mujore,
- (v) kërkuar që në ndërtesa kolektive, në të cilat nuk ka mundësi teknike të vendosjes së ujëmatësave individual, faturimi të bëhet në bazë të ujëmatësës të përbashkët dhe në përputhje me mënyrën e paraparë ligjore,
- (vi) përfunduar inspektime të rregullueshmërisë së faturimit në ndërtesa kolektive dhe për parregullsitë e konstatuara kemi kërkuar nga KRU, të bëhen korigjimet e duhura.

Edhe në të ardhmen, ne do të vazhdojmë të punojmë që konsumatorët të kenë një faturim të drejtë dhe të saktë për shërbime që janë duke marrë. Ne jemi të bindur dhe do të punojmë shumë për ti bindur edhe të tjerët (Ofruesit e shërbimeve), se konsumatorët të cilët janë përfituesit e shërbimeve të tyre, meritojnë vlerë në shërbime cilësore për paratë që paguajnë dhe për këtë arsye, ZRRUK do të zbatoj me vendosmëri përgjegjësitë ligjore dhe institucionale duke luajtur një rol kyç në këtë drejtim.

Së fundi unë do të doja të përfitoj nga ky rast të falënderoj të gjithë stafin e Zyrës sonë, dhe zyrtarët e Ofruesve të shërbimeve për punën dhe përkushtimin e tyre.

Raif Preteni

Drejtor i ZRRUK



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, është një Institucion i pavarur me përgjegjësin për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë. Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, është themeluar zyrtarisht në vitin 2004, përmes Rregullores së UNMIK-ut, 2004/49, në vazhden e reformave institucionale të ndërmarra nga institucionet vendore me qëllim të krijimit të një sektorit të qëndrueshem dhe efektiv. Në Qershor të vitit 2008, me largimin e administratës ndërkombëtare nga Kosova, përmes Ligjit, Nr. 03/L-086, llogaridhënja dhe përgjegjësia e ZRRUK, u transferua tek institucionet vendore, gjegjësisht në Kuvendin e Kosovës. Roli kryesor i ZRRUK pra, është për të menaxhuar një kornizë efektive rregullatore, e cila inkurajonë ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë, për të siguruar një shërbim me cilësi të lartë dhe në vlerë për të holla që paguajnë Konsumatorët.

Në mënyrë me specifike roli dhe përgjegjësit e ZRRUK, konsistojnë në:

- Sigurimin se Ofruesit e shërbimeve të ujit të kenë një licencë të shërbimit. Ne pra, monitorojmë performancën e kompanive të licencuara, në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore.
- Përcaktimin e tarifave të shërbimit, që të jenë të mjaftueshme dhe njëkohësisht të përballueshme për konsumatorët. Ne pra, aprovojmë tarifatat të cilat reflektojnë investimet që secila kompani duhet të bëjë për të përmirësuar sigurinë e furnizimit të saj, duke i mbajtur shpenzimet e operimit sa me poshtë.
- Monitorimin e Performancës dhe Vlerësimin Krahasues (Bechmarking), me qëllim të rritjes së besueshmëris, transparencës si dhe për të vlerësuar progresin drejtë rezultateve të përmirësuar të menaxhimit të shërbimeve të ujit nga të gjithë, ofruesit e shërbimeve. Ne pra, përdorim një numër të mjeteve për të sfiduar ofruesit e shërbimeve në të gjitha ato pika të dobëta të identifikuara, me qëllimin e përmirësimit të tyre, duke u siguruar që ata i përgjigjen pozitivisht këtyre sfidave.
- Përcaktimi dhe mbikqyrja e standardeve të shërbimit, se sa ato janë duke u përmbushur gjatë dhënjes së shërbimit. Ne pra, kemi kompetenca, nëse është e nevojshme, për të marrë masa ndëshkimore ndaj kompanive, nëse ato dështojnë në përmbushjen e standardeve gjatë ofrimit të shërbimeve për konsumatorët e tyre.
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Ne pra, kemi involvuar përfaqësuesit e Konsumatorëve në shqyrtimin dhe zgjedhjen e ankesave për të cilat ata, nuk kanë marrë përgjigje të kënaqshme nga Ofruesi i tyre i shërbimeve, si dhe për, ta konsultuar Rregullatorin në çështje të ndryshme Rregullatore.

ZRRUK, është i orientuar drejt rezultateve konkrete, duke mos ndërhyrë drejtëpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licensuar të shërbimeve, dhe duke e lënë këtë përgjegjësi për menaxhmentin e Ofruesit të shërbimit, të cilët kanë një detyrë të përgjithshme për të ruajtur dhe zhvilluar një sistem efikas dhe ekonomik të furnizimit me ujë.

Për të arritur objektivat tona, ne punojmë ngushtë me të gjitha palët e interesit; Ofruesit e shërbimeve (KRU), Konsumatorët, Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës, si dhe me Agjensionet zhvillimore të angazhuara në këtë sektorë.

1 HYRJJE

ZRRUK në bazë të ligjit Nr. 03/L-086, ka mandatin, për të siguruar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë dhe të shërbimit të kanalizimeve në Kosovë. Një nga përgjegjësit e saja është Monitorimi i performancës dhe raportimi tek publiku. Në këtë mënyrë ZRRUK, përmbush njërin nga funksionet e saja për të shpërndarë informacione për publikun mbi performancën e sektorit dhe KRU. Raporti mbi performancën e ofruesve të shërbimeve dhe sektorit është një nga rrugët e përdorura për të arritur këtë funksion, deri më tani shtatë raporte janë botuar nga ZRRUK që nga viti 2006.

Ky raport paraqet rezultatet e vlerësimit të performancës së Ofruesve të Shërbimeve të ujit në Kosovë, është bazuar në analizën e të dhënave të raportuara nga KRU, në kuadër të kornizës raportuese (Raportit vjetor dhe Mujorë), të cilat i janë nënshtruar auditimit/verifikimit Rregullator. Raporti ofron një analizë objektive të treguesve të performancës që përfshijnë aspektet më të rëndësishme të punës së Ofruesve të shërbimeve, identifikon pikat e forta dhe të dobëta dhe komenton një sërë propozimesh për përmirësim.

Raporti përfshinë të gjitha fushat kritike të performancës së KRU, duke përfshirë aspektet operative, financiare dhe shërbimit ndaj konsumatorëve. Raporti pra, ofron analiza dhe informacione për të shtatë, KRU që furnizojnë qytetarët e Kosovës, me shërbimet e ujit. Të gjeturat në këtë raport, kanë për qëllim për të mbështetur; Rregullatorin e Ujit, Ofruesit e shërbimeve, Qeverinë e Kosovës, si dhe Donatorët e sektorit të ujit, në përpjekjet e tyre, për të përmirësuar performancën e KRU dhe sektorit të ujit në përgjithësi në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Raporti është përgatitur në 4 pjesë:

- Pjesa A: Analiza krahasuese e performancës së KRU, e nxjerrë në pah, punën e shtatë KRU e cila është arritur duke përdorur një numër treguesish të punës, të cilat prekin çështjet e furnizimit me ujë, shërbimet për ujëra të zeza, performancën financiare, si performancën e përgjithshme të KRU.
- Pjesa B: Analiza krahasuese e performancës së përgjithshme e sektorit, jep një pasqyrë të performancës së sektorit në përgjithësi, bazuar në treguesit e ujit të prodhuar, shitjet dhe UPF, mbulueshmëria me shërbime, të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paranë e gatshme të arkëtuar, si dhe shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale), për një periudhë 4 vjeçare.
- Pjesa C: Pasqyron performancën e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Ibër-Lepenci)
- Pjesa D: përfshinë performancën dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK).

Si pjesë e veçantë janë dhënë edhe disa, Shtojca: të cilat përmbajnë të dhënat e detajuara të performancës, definicionet e treguesve, pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrat tarifore (2012-2014) si dhe detajet kontaktuese me përshkrimin e zonave të shërbimit të KRU.

2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

Edhe viti 2012, është karakterizuar me disa zhvillime të rëndësishme në sektorin e shërbimeve të ujit në Kosovë.

Aprovimi i Udhëzimit Administrativ 16/2012 për Cilësinë e Ujit

Në fund të vitit 2012, nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, është aprovuar 'Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu'. Me këtë, Udhëzim Administrativ synohet mbrojtja edhe më e mirë e shëndetit të popullatës nga efektet negative të ndonjë kontaminimi të ujit që përdoret për konsum nga njeriu, duke siguruar që ai ujë të jetë i shëndetshëm dhe i pastër. Në fakt ky udhëzim ka zavendësuar, udhëzimin e mëhershëm 2/1999', dhe në terësi ka transpozuar direktiven e ujit të pijshëm të KE, në legjislacionin vendor.

Është me rëndësi të potencohet se me fillimin e zbatimit të mënjëhershëm të këtij, udhëzimi si dhe krijimi i 'Qendrës së Ujit', në kuadër të IKSHPK, çështja e kualitetit të ujit ka marrë një dimension të ri, i cili padyshim se do të ketë impaktë në sigurimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit të ujit të furnizuar nga KRU. Përveq, rëndësisë së faktit, se vlerat parametrike janë të unifikuara me ato të Direktives së Ujit të Pijshëm (98/83/EC), të Bashkimit Evropian, me rëndësi është së monitorimi i kualitetit të ujit, është paraparë të bëhet në dy nivele, monitorimi i jashtëm i cili do të jetë ekskluzivisht çështje e autoritetit shëndetësor (IKSHPK) dhe monitorimi i brendshëm i cili do të jetë nën përgjegjësinë e Ofruesve të Shërbimeve.

Aprovimi dhe zbatueshmëria e tarifave për periudhën (2012-2014)

Tarifat e reja për shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza, të cilat ne i kemi aprovuar për tri vitet e ardhshme (2012-2014) kanë, filluar të zbatohen nga 1 Janari 2012, nga secila prej shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU).

Ne kemi marrë parasysh kërkesat e ofruesve të shërbimeve nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU, por gjithnjë duke marrë parasysh interesat e konsumatorëve për të përmirësuar nivelin e shërbimit si dhe mundësit aktuale të konsumatorëve për të paguar. Raportet vjetore të performancës të publikuara vit pas viti, kanë identifikuar dështimet e shumta në sigurimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimet e ujërave të zeza në Kosovë. Në veçanti, nivelet e shërbimit në lidhje me cilësinë e ujit, mbulueshmëria me shërbime (ujë dhe ujëra të zeza), besueshmëria e furnizimit me ujë, humbjet e ujit, dhe cilësia e shkarkimit të ujërave të zeza, të cilat janë shumë më poshtë se niveli i shërbimeve në një vend modern Evropian. Këto mangësi, megjithatë, mund të zgjidhen vetëm përmes investimeve të dukshme e të konsiderueshme në sektor (kryesisht përmes tarifave).

Tarifat e reja kanë parashikuar rritje reale të faturave të konsumatorëve shtëpiak dhe jo shtëpiak, për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza. Nga të gjitha KRU, pritet që të realizojnë një program investimesh të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimin e ujërave të zeza dhe nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare tarifore (2012-2014), prej afro 95 milion Euro, nga mjetet vetanake të KRU është planifikuar të investohen rreth 25 milion euro, në shpenzime kapitale. Realizimi i investimeve të parapara sipas lartësisë dhe dinamikës së planifikuar, qoftë nga mjetet vetanake qoftë me mjetet

financiare nga donatoret do të sjellë përmirësim dhe rritjen e aseteve të cilat janë parakushte për ofrimin e shërbimeve të mira dhe të qëndrueshme.

Është e rëndësishme që KRU-të, kanë pranuar se planet e biznesit që ata kanë dorëzuar dhe të cilat ne i kemi përdorur si bazë për përcaktimin e tarifave janë "obligimet kontraktuese" e nënkuptuar, në këmbim me tarifat e dakorduara.

Rishqyrtimi i tarifave për vitin 2013

Edhe pse nga KRU, kemi pritur që të ndërmarrin, aktivitete shtesë që ti realizojnë objektivat e tyre të parashikuara në planet e tyre të biznesit, të cilat kanë reflektuar në tarifat që ne i kemi vendosur, ne kemi qenë këmbëngulës në vendosmërinë tonë për të siguruar që KRU të përmbushin detyrimet e tyre të kontraktuara. Në mënyrë rigoroze kemi monitoruar performancën kundrejt detyrimeve të tilla dhe publikisht ju kemi tërhequr vërejtjen KRU, që në raste se nuk përmbushin detyrimet e tyre, ne do të bëjmë rishqyrtimin e tarifave për vitin vijues (2013). Në fund të vitit 2012, ZRRUK ka publikuar raportin mbi arritshmërinë e objektivave. Me keqardhje kemi konstatuar se gjatë vitit 2012, KRU kanë dështuar në arritjen e shumicës së objektivave të dakorduara, përfshirë edhe investimet kapitale të planifikuara.

Duke u nisur nga fakti se asnjë nga KRU, nuk kanë arritur ti përmbushin caqet për investime kapitale, ZRRUK për këtë ka ndëshkuar kompanitë. Në fakt gjatë rishqyrtimit të rregulltarit e paraparë, për të rishqyrtuar tarifat në përputhje me normën e inflacionit. ZRRUK ka bërë rregullimet e duhura për shkallën e inflacionit dhe njëkohësisht ka aprovuar zbritjen e tarifave në përputhje me normën e përmbushjes së objektivave të investimeve kapitale, ndaras për secilën KRU. Në këtë mënyrë tarifat e vitit 2013, kanë pësuar ngritje simbolike për disa KRU dhe në përgjithësi për konsumatorët shtëpiak, përderisa në disa raste për konsumatorët jo-shtëpiak ato edhe janë zvogëluar apo kanë mbetur të njejta si në vitin 2012.

Rregullorja mbi kriteret për thëmelimin e ndërmarrjeve publike lokale Nr. 02/2013

Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, i cili është në fuqi, nga qershori i vitit 2008, është amendamentuar, në prill 2012 përmes Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Ligji i amendamentuar ka marrë në konsiderat përfaqësimin me të madhë të Komunave në Ndërmarrjet Publike, po ashtu ligji ka lënë mundësinë për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale. Në përputhje me këto ndryshime, plotësimet në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike, Qeveria po ashtu në vitin 2012, ka nxjerrë edhe 'Rregulloren me Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit'. Sipas kësaj Rregulloreje është paraparë që në Bordet e Drejtorëve të secilës KRU, të paktën gjysma e Drejtorëve, duhet nominuar dhe zgjedhur kandidat nga Komunitat, ku ofron shërbimet KRU. Aktualisht, Qeveria është në fazën e zgjedhjes së Bordeve të reja për KRU. Komunitat të cilat nuk kanë struktura të organizuara për menaxhimin e ujësjellësave dhe të cilat aktualisht kanë skema të ndërtuar të ujësjellësave e të cilat janë nën mbikqyrjen e Drejtorateve Komunale (P.sh, Novobërdë, Shtërpçë, etj), duhet sa më shpejt të themelojnë, Ndërmarrjet e tyre publike lokale, në përputhje me këtë Rregullore. Ato fillimisht duhet nënshtruar procesit të konsolidimit dhe korporatizimit në kuadër të KRU respektive dhe në këtë mënyrë të licencohen dhe ti nënshtrohen rregullativës ekonomike të zbatuar nga ZRRUK.

Pjesa A:

Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjetës-Kanalizimit

3 PERFORMANCA E KRU

Në këtë pjesë të raportit ne kemi vlerësuar performancën individuale të secilës kompani në vitin 2012, duke e krahasuar me performancën e saj të arritur në vitin 2011, si dhe është vlerësuar performanca e kompanive në raport me njëra tjetrën. Për më tepër në mënyrë më specifike kemi bërë një vlerësim të performancës në raport me përmbushjen e objektivave të projektuara në planet e bizneseve të KRU, të cilat janë aprovuar nga Rregullatori, gjatë procesit tarifar (2012-2014), për vitin 2012. Vlerësimi i performancës është bërë ndaras për të dy shërbimet (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza).

3.1 Furnizimi me ujë

Shërbimi i furnizimit me ujë, përfshinë furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës nga shtatë KRU, në kuader të zonave të tyre respektive të shërbimit. Ky shërbim, konsiderohet shërbim me interes të përgjithshëm i cili është thelbësor për mirëqenjen dhe shëndetin publik, prandaj është e rëndësishme që kompanitë të japin këtë shërbime me standarde të vazhdueshme dhe të lartë të cilësisë së shërbimit dhe me kosto efiçente. Në vazhdim është pasqyruar një përmbledhje e performancës aktuale të ofruesve të shërbimeve në furnizimin me ujë, përfshirë, aspektin teknik, shërbimit ndaj konsumatorëve si dhe aspektin financiar.

3.1.1 Performanca teknike

Efektiviteti i KRU gjatë furnizimit me ujë është vlerësuar duke përdorur treguesit e standardeve dhe ato operative, përfshirë: Kualitetin e ujit, presionin adekuat në rrjetin e ujësjellësit si dhe disponueshmërinë e furnizimit me ujë.

Kualiteti i ujit

Kualiteti i ujit, është një nga standardet më të rëndësishme të shërbimit të furnizimit për faktin se ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullatës. Niveli i pajtueshmërisë merr parasysh përqindjen e rezultateve që plotësojnë standardin e cilësisë së ujit. Prandaj është e rëndësishme të theksohet se një pajtueshmëri e ulët mund të nënkuptojë mangësi në cilësinë e ujit. Figura.1 pasqyron përqindjen e testeve ku përputhshmëria Mikrobiologjike dhe Fiziko – Kimike, është arritur në raport me vlerat parametrike të standardeve vendore për kualitetin e ujit të pijshëm¹.

Pajtueshmëria vlerësohet në bazë të rezultateve të raporteve të dërguara nga IKSHPK, tek i cili është përgjegjësia institucionale vendore për monitorimin dhe testimin e kualitetit të ujit të furnizuar nga ofruesit publik të shërbimeve të ujit. ZRRUK, në bazë të analizave që ka bërë nga këto raporte ka vlerësuar gjendjen e kualitetit të ujit të ofruar nga KRU si më poshtë.

¹ ‘Udhëzimi Administrativ NR. 16/2012, për kualitetin e ujit të pijshëm për konsum nga njeriu’, ka hyrë në fuqi nga fillimi i vitit 2013, Në të janë përcaktuar vlerat parametrike (Fiziko-Kimike dhe Mikrobiologjike), që duhet të arrihen për ujin e distribuar tek konsumatorët.




Figura 1, Rezultatet e testimit të cilësisë së ujit

Pajtueshmëria mikrobiologjike

Në përgjithësi kualiteti i ujit në aspektin mikrobiologjik është me i përmirësuar në vitin 2012, në krahasim me vitin paraprak për 1%. Nga pesë KRU (Hidrodrini, Radoniqi, Hidromorava, Mitrovica, Hidroregjioni Jugor), është raportuar përmirësim i performancës së kualitetit të ujit në aspektin mikrobiologjik. Përkundërazi në KRU (Prishtina dhe Bifurkacion), dështimet e testeve mikrobiologjike janë më të larta në vitin 2012, në raport me vitin 2011. Në KRU 'Prishtina', probleme janë evidentuar në Komunën e Drenasit, përderisa KRU 'Bifurkacioni' vështirësi në sigurimit të kualitetit të ujit i kanë në disa skema rurale të cilat menaxhohen prej saj. Kontaminimi bakteriologjik kryesisht dominohet nga bakterjet koliforme, apo në ndonjë rast edhe e-coli. Shkaku i mos-pajtueshmërisë nuk është gjithmonë i gjurmueshëm. Ne mendojmë se tek rastet e mos-pajtueshmërisë, mikrobiologjike ka ndikuar teknika dhe dozimi jo efektiv si dhe ndërprerjet e furnizimit me ujë për shkak të reduktimeve të cilat aplikohen nga këto dy kompani.

Nga KRU 'Hidrodrini' dhe 'Radoniqi', është raportuar të kenë pajtueshmërin 100%, të cilësisë së ujit nga aspekti Mikrobiologjik.

Pajtueshmëria fiziko –kimike

Nga aspekti fiziko- kimik uji i cili furnizohet nga kompanitë publike, është në një shkallë më të mirë të përputhshmërisë me parametrat e lejuar, problemet me të mëdha aktualisht janë, në KRU 'Hidrodrin' gjegjësisht në Nj.O 'Kline', ku janë evidentuar norma me të larta të manganit (Mg) dhe të nitriteve (NO₂).

Përndryshe në të gjitha KRU e tjera, përputhshmëria me parametrat Fiziok-Kimik, është e lartë (mbi 97%).

Gjatë vitit 2012, poashtu edhe në vitin 2011 KRU 'Radoniqi', për konsumatorët e tij e ofron cilësinë më të mirë të ujit të pijshëm me kalueshmëri të testeve (mikrobiologjike dhe fiziko-kimike), përafërsisht me 100%, përputhshmëri me vlerat parametrike të standardeve vendore.

Presioni

Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ultë duke përjashtuar rastet aksidentale të herë pas hershme të rënjes së presionit. Presioni i ujit në rrjetin e ujësjellësit është një nga standardet e rëndësishme të shërbimit i cili drejtperdrejtë ndikon në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimin e furnizimin me ujë. Standardet vendore të shërbimit, kanë paraparë vlerat referuese², të cilat duhet të arrihen për presion minimal dhe maksimal në pikën e kyqjes së shërbimit të konsumatorit.




Figura 2, Presioni në rrjetin e ujësjellësit

Gjatë vitit 2012 KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Mitrovica', kanë raportuar të kenë vështirësi më të mëdha në raport me kompanitë e tjera. Të dhëna krahasuese me vitin e kaluar për këto dy kompani, nuk ka pasur mundësi të bëhen, meqë në vitin 2011 nuk kanë raportuar informacione për presionin.

Sipas performancës së dalë nga të dhënat e raportuara gjatë vitit 2012, shihet se nuk kemi probleme të mëdha sa i përket presionit, pasi që në nivel të sektorit kjo vlerë ka mbetë në nivel të njëjtë me vitin 2011, e cila është nën vlerën 5%.

Është evidente se asnjë nga KRU, nuk kanë zhvilluar programe për menaxhimine presioneve në zonat e tyre të shërbimit. Menaxhimi dhe sjellja e presioneve në nivelet e lejuara, është e rëndësishme për ruajtjen e infrastrukturës, dhe njëkohësisht, është shumë e domosdoshme gjatë aktiviteteve të menaxhimit të humbjeve fizike si dhe sigurimit të cilësisë së ujit.

KRU, të cilat kanë raportuar të kenë probleme me presion të ulët në rrjetin e ujësjellësit kanë zakonisht edhe probleme me ndotje bakteriologjike. Një pjesë të kontaminimeve të ujit të pijshëm të elaboruar tek kulliteti i ujit pa dyshim, është si rezultat i hyrjes së kontaminimit nga jashtë në rrjetin e ujësjellësit. Është e njohur se me një presion adekuat dhe mbrenda vlerave parametrike ligjore të përvetësuar, do ta mban larg ujin e kontaminuar që të mos hyjë në rrjetin e ujësjellësit.

² Presioni minimal 25 m. sh.u dhe presioni maximal 70 m.sh.u

Vazhdimësia e furnizimit

Furnizimi i rregullt me ujë, krahas cilësisë së ujit është i një rëndësie të madhe për konsumatorët dhe duke përjashtuar problemet e faturimit, kjo është një fushë ku janë shumica e ankesave të adresuara nga konsumatorët.




Figura 3, Vazhdimësia e furnizimit (2012) e paraqitur si numri i konsumatorëve të ndikuar nga ndërprerjet e rregullta të furnizimit me ujë.

Në këtë figurë, është pasqyruar numri i konsumatorëve të prekur/ndikuar nga vazhdimësia e rregullt e furnizimit me ujë, të ndara në tri grupime: (i) konsumator me 24 orë shërbim në ditë, (ii) konsumator me 18-23 orë shërbim në ditë dhe (iii) ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Vetëm tri KRU ('Hidrodrini', 'Hidromorava' dhe KRU 'Radoniqi'), kanë arritur të furnizojnë të gjithë konsumatorët e tyre për 24 ore ujë të pijshëm.

KRU, të cilat vazhdojnë të kenë vështirësi të mëdha edhe në vitin 2012, me furnizimin me ujë ende mbeten KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina', edhe përkundër se këtë vit nga KRU 'Prishtina', është raportuar të ketë përmirësim në këtë drejtim si rezultat i disa investimeve direkte në rrjetin e ujësjellësit. Në KRU 'Mitrovica' angazhimet konkrete, në zgjerimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese pritet që shumë shpejtë të sjellin rezultate në përmirësimin e furnizimit të rregullt.

Përmirësime të konsiderueshme janë arritur në këtë drejtim nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', kjo kompani ka investuar në burime dhe në zgjerimin e kapaciteteve të furnizimit me ujë. Po ashtu kjo kompani është duke u angazhuar që për një numër të vogël konsumatorësh (600-sishë), në Nj.O 'Prizren', që aktualisht kanë problem me furnizim të rregullt për shkaqe teknike, të bëjë zgjidhje të qëndrueshme.

Shërbyeshmëria infrastrukturore

Treguesit të cilët përcaktojnë shërbyeshmërinë infrastrukturore janë: plasaritja e gypave si dhe uji i pa-faturuar, dhe definohet si aftësia e aseteve për të ofruar nivelet e kërkuara të shërbimit.

Plasja e gypave

Ky tregues, paraqet numrin total të plasjeve brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të gypave, në sistemin e shpërndarjes i cili është nën përgjegjësin e menaxhimit të kompanisë d.m.th, përjashton pjesën e plasjeve të cilat ndodhën në pjesën e përgjegjësisë së konsumatorit si dhe të sistemit të brendshëm të konsumatorit.




Figura 4, Plasjet e gypave të ujësjellësit

Në përgjithësi norma e plasjeve në nivel të sektorit në vitin 2012, është raportuar të jetë më e ulët për 33%, se sa ishte në vitin 2011. Përveç, KRU 'Prishtina' dhe 'Radoniqi', në të gjitha KRU e tjera ka pasur më pak plasje të gypave në sistemin e ujësjellësit.

KRU 'Hidromorava', ende mbetet kompania e cila ka numrin më të lartë të plasjeve të gypave nga të gjitha kompanitë e tjera me 441 (plasje/100km), megjithatë në vitin 2012, ka përmirësuar dukshëm gjendjen e gypave në krahasim me një vit më parë. Plasje me pak të gypave nga të gjitha KRU e tjera janë shënuar në KRU 'Bifurkacion', me 141 (plasje/100 km). KRU 'Mitrovica', ka shënuar përmirësimin më të lartë, në këtë tregues. Kjo kompani është në vazhden e programeve të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe të ripërtëritjes së sistemit të gypave.

Kryesisht numri i plasjeve të gypave është ndikuar nga: vjetërsia dhe gjendja e rrjetit, materiali i gypave si dhe lartësia e pa kontrolluar e presionit. Numri i lartë i plasjeve arsyetohet me faktin se KRU, në përgjithësi janë duke shpenzuar ende shumë pak në mirëmbajtjen e rrjetit të furnizimit me ujë se sa është e nevojshme. Nuk ka asnjë dyshim se është mëse e rëndësishme që rritja e shpenzimeve në ripërtëritje infrastrukturore është thelbësore nëse duam që të parandalojmë përkeqësimin e niveleve të shërbimit.

Uji i pa-faturuar (UPF)

Uji i pa-faturuar (sasi absolute) është diferenca ndërmjet sasisë së ujit të prodhuar dhe sasia e ujit të faturuar, që d.m.th, mbetet si ujë i cili nuk sjellë të ardhura për kompaninë përkundraz, krijon shpenzime të mëdha. UPF përbëhet prej humbjeve teknike (p.sh. për shkak të rrjedhjeve) dhe humbjeve komerciale (lidhjet e paligjshme).




Figura 5, Uji i pa-faturuar (sasi absolute)

Nga figura 5, mund të shohim se shumica e KRU perveq, KRU 'Hidromorava' ishin në gjëndje për të realizuar një rënje UPF.

Në vlerë sasiore UPF, në nivel të sektorit është me e ulët në vitin 2012 për rreth 10 milion m³. Kjo rënje, me shumë mund ti atribuohet uljeve të prodhimit të ujit se sa ndonjë veprimi i cili do të jetë pjesë e programeve për reduktimin e UPF.

Vetëm KRU 'Radoniqi' gjatë vitit 2012 krahasuar me 2011, ka raportuar sasi me të vogël të prodhimit të ujit me vlerë mbi 5 milion m³.

Kjo ilustron edhe me faktin se të gjitha KRU, të cilat kanë zvogëluar prodhimin e ujit kanë shënuar edhe ulje të UPF, për dallim nga KRU 'Hidromorava', e cila ka rritje të UPF, por edhe rritje të prodhimit në vitin 2012.

Nëse humbjet e larta të ujit (UPF) përkthehen në terma monetarë, mund të merrni një kuptim për shumën e të hyrave të humbura dhe madhësisë së problemit. Kjo duhet të shërbejë si një nxitje për secilën KRU për të dalë me një strategji për të realizuar disa prej këtyre të ardhurave.

Treguesi UPF litër për konsumatorë në ditë paraqet volumin mesatar të UPF, në raport me totalin e konsumatorëve në zonën e shërbimit. Ky tregues është i rregulluar për orët e furnizimit me ujë, për tu bërë i krahasueshëm, mëqenëse në disa KRU janë duke aplikuar regjim të kufizuar të furnizimit.




Figura 6, Performanca krahasuese për UPF, paraqitur (l/k/d) dhe si (%)³

KRU 'Hidromorava', është ranguar në pozitën më të mirë sa i përket UPF (liter për kyqje në ditë), me humbjet më të vogla prej 649 l/k/d e cila në raport me vitin 2011 ka mbetë pothuajse në pozitën e njëjtë.

Tek KRU 'Radoniqi', shihet një progres mjaft i madhë, gjatë vitit 2012 në raport me vitin 2011, të ky tregues në këtë rezultat ka ndikuar burimi i informacionit i cili këtë vit, ka qenë më ndryshe nga viti i kaluar kur të dhënat janë marrë nga ujëmatësi në dalje të fabrikës.

Kompania e cila është ranguar e fundit për vitin 2012, është KRU 'Hidrodrini' me humbje prej 1,463 l/k/d i rregulluar edhe pse siq shihet edhe nga figura 6, në raport me vitin 2011, sa ishte 1,635 l/k/d ky tregues ka shënuar përmirësim.

Të gjitha kompanitë në përjashtim të KRU 'Mitrovicës', kanë shënuar përmirësim tek UPF shprehur në l/k/d gjatë vitit 2012 në raport me vitin 2011.

UPF i shprehur në përqindje llogaritet si përqindje e sasisë së ujit të shitur në raport me sasinë e ujit të prodhuar, është përdorur sa për ilustrim edhe pse është një tregues i thjeshtë megjithatë ofron një pasqyrë të shpejtë të UPF.

Të gjitha KRU kanë shënuar trend pozitiv në vitin 2012, krahasuar me vitin 2011 në përjashtim të KRU 'Hidromoravës' e cila ka pas rritje për 2% dhe KRU 'Mitrovicës' e cila ka mbetë në pozitën e njëjtë. Në nivel të sektorit UPF në vitin 2012 është 60%, dhe ka shënuar progres për 3%, në raport me vitin 2011.

Është më se e qartë se ndaj KRU, nuk është duke u bërë presion i mjaftueshëm nga institucionet përgjegjëse dhe publiku për të ndërmarr veprime të mjaftueshme dhe të planifikuara për të reduktuar humbjet e ujit. Në mënyrë që të sjellë UPF në një nivel të pranueshëm, KRU fillimisht duhet të bëjnë vendosjen e ujëmatësave për të gjithë konsumatorët, të vendosin një numër të mjaftueshëm të ujëmatësave zonal për të detektuar rrjedhjet, të azhurnojnë bazën e të dhënave të konsumatorëve në menyrë që të shmangen lidhjet e paligjshme, si dhe të sigurojnë faturim korrekt dhe në kohë duke eliminuar parregullsit lidhur me leximin e ujëmatësave.

³ Vlera e UPF për kyqje në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.

3.1.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujë.




Figura 7, Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit në vitin 2012, është në nivelin 78%, kjo është për 4%, më e përmirësuar se në vitin 2011.

Gjatë vitit 2012, shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit e ka KRU 'Radoniqi' me 96% edhe pse krahasuar me vitin 2011, ka një rënie të vogël por kjo ka ndodhë për arsye të shtimit të numrit të ekonomive familjare për një pjesë të regjionit të Prizrenit, e cila është nën menaxhimin e KRU 'Radoniqi'.

Shkallën më të ultë të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit, gjatë vitit 2012, e ka shënuar KRU 'Hidromorava' me 57%, mirëpo krahasuar me vitin 2011, mbulueshmëria nga ana e kësaj kompanie ka shënuar rritje.

Objektivat për rritjen e mbulueshmërisë me shërbime nga KRU, të projektuar gjatë procesit tarifar në mesatare të sektorit është përmbushur, për faktin se numri i konsumatorëve të rinjë të kyqur në shërbimet e furnizimit me ujë nga KRU, është për 10,413 sish, si rezultat i zgjerimit të shërbimeve të ujësjellësit nëpër zonat rurale.

Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar, është një parakusht për të ngarkuar, konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real. Po ashtu ky është një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.



Figura 8, Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatësa

Në figuren 8, është pasqyruar norma e konsumatorëve shtëpiak të cilët janë, paisur me ujëmatësa në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak të shërbyer.

Në nivel të sektorit mbulimi me ujëmatësa për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak është rritur dhe në vitin 2012 ka arritur nivelin në 89%.

Përmirësime në normën e paisjes së konsumatorëve me ujëmatësa gjatë vitit 2012, janë shënuar tek të gjitha KRU. Në vitin 2012, është parë se të gjitha KRU, kanë intensifikuar programet e tyre me qëllim që të gjithë konsumatorët e tyre, ti paisin me ujëmatësa. Si rezultat i këtyre aktiviteteve, janë raportuar që vetëm në vitin 2012, janë vendosur mbi 12,000 ujëmatësa të rinj nga të gjitha kompanitë.

KRU 'Prishtina' me 96%, është kompania me proporcionin më të lartë të konsumatorëve me ujëmatësa. Përderisa KRU 'Mitrovica', ngelet në nivel jo të kënaqshëm ku vetëm 57% e konsumatorëve shtëpiak janë të paisur me ujëmatës, edhe pse ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2011.

ZRRUK, duke qenë i informuar se shumë ankesa të konsumatorëve kanë të bëjnë me parregullsit në faturimin e konsumatorëve, të identifikuar gjatë inspektimeve rregullatore, por edhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore në këtë aspekt, në vazhdimësi ka kerkuar që Kompanit të paisin të gjithë konsumatorët e tyre me ujëmatësa dhe faturimin e tyre, ta bëjnë ekskluzivisht përmes leximit të rregullt të ujëmatësave.

Ankesat

Ky tregues raporton numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga KRU. Me ankesë nënkuptojmë një paraqitje me shkrim apo me gojë nga ana e konsumatorit dhe është shprehja e pakënaqësisë në lidhje me ndonjë veprim apo mos veprim nga ana e kompanisë. Numri i ankesave të paraqitura është një tregues i nivelit të shërbimit ndaj konsumatorëve dhe moskënaqësisë së tyre.




Figura 9, Ankesat për furnizim me ujë

Në përgjithësi kemi rritje të numrit të ankesave për shërbimet e ujit. Në total për vitin 2012 nga të gjitha KRU, janë raportuar gjithsejtë 14,745 ankesa dhe ky numër është rritur për 4%, në raport me vitin 2011. Pa dyshim se një numër i tyre në rritje mund të jetë për shkak të moskënaqshmërisë së konsumatorëve me nivelin e shërbimit. Por ne jemi të bindur se një pjesë e tyre është rritur edhe për shkakun se konsumatorët kanë filluar të binden së ja vlenë për tu ankuar. KRU, gjithnjë e më shumë janë të përkushtuar për ti shqyrtuar dhe azhurnuar në mënyrë sa më të rregulltë dhe të shpejtë ankesat e adresuara nga konsumatorët, prandaj edhe ata, janë duke adresuar edhe më tepër ankesa tek ofruesi i tyre i shërbimeve.

Edhe pse ka rënje të ankesave për aspektet teknike për 9%, edhe më tej pjesa më e madhe e ankesave rreth 62% e tyre, kanë të bëjnë me çështjet teknike. Megjithatë në vitin 2012, rritje të konsiderueshme me rreth 38%, kanë shënuar ankesat e konsumatorëve në aspektet komerciale.

Ankesat teknike, kryesisht lidhen për shkak të furnizimit jo të rregullt, ndërprerjeve dhe defekteve të shpeshta në rrjetë si dhe kualitetin e ujit. Përderisa ankesat e natyrës komerciale me tepër janë për shkakun e kontestimit të saktësis së faturimit dhe mënyrës së faturimit (faturimi paushall dhe faturimi në banesa kolektive, etj).

Numri i ankesave ndaj shërbimeve të ujit për 1 000 konsumatorë në nivel të sektorit në vitin 2012 është 59 ankesa për 1 000 konsumatorë, dhe ka mbetur e njëjtë me vitin 2011.


3.1.3 Performanca Financiare

Në vazhdim të raportit janë analizuar, aspektet financiare të furnizimit me ujë të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

Shitjet

Volumi i ujit të shitur

Ky tregues pasqyron, volumin e ujit të shitur në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU gjatë procesit tarifar aktual (2012-2014).



Vëllimi i ujit të shitur si përqindje e vëllimit të shitjeve të planifikuara

Figura 10, Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifor (2012-2014)

Gjatë vitit 2012 të gjitha KRU kanë shënuar performancë më të ultë në këtë tregues në raport me vitin 2011, në përjashtim të KRU 'Hidrodrinit' e cila ka shënuar trend pozitiv në drejtim të përmbushjes së planifikimeve të shitjeve të ujit.

Nga të gjitha KRU për vitin 2012, është planifikuar të shiten mbi 59 milion m³ ujë, përderisa realizimi ishte rreth 54 milion m³, që është me pak për 5 milion m³, apo shprehur në %, realizimi i shitjeve të planifikuara në nivel të sektorit është 91%.

KRU 'Hidrodrini', është kompania e vetme e cila ka realizuar planifikimet e shitjeve volumetrike të ujit. Përderisa KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 98% si dhe KRU 'Radoniqi' me 96% kanë qenë afër realizimit të përmbushjës së objektivave planifikuese. Kompanitë tjera përfshirë KRU (Prishtinën, Hidromoravën dhe Mitrovicën) janë nën vlerën 90%, të përmbushjës së caqeve të planifikuara të shitjet volumetrike të ujit. Ndersa KRU Bifurkacioni ka qenë me se largu në përmbushjen e synimit të shitjeve të ujit me vetem 76%.

Mos arritja e objektivave të shitjet sasiore (volumetrike) të ujit ka shkaktuar që kompanitë mos të kenë të ardhura të planifikuara për të përmbushur nevojat e tyre financiare dhe janë reflektuar në kufizime në shpenzimet e mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes infrastrukture.

Vlera e shitjeve (EUR)

Në Figurën 11, janë paraqitur vlerat totale të shitjeve të ujit në raport me vlerësimin e shitjeve sipas planit të bizneseve për periudhën raportuese




Figura 11, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Vlera e shitjeve për çdo KRU ishte shumë me e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve, rezultat i të cilës janë parashikimet e dobëta të volumeve të shitjeve. Në rastin më të mirë mund ta veçojmë KRU ‘Radoniqi’, e cila ka arritur nivelin prej 94% në vitin 2012, dhe e cila është me e ulët për 3% krahasuar me 2011. KRU ‘Bifurkacioni’, ka arritur vetëm 79% të arrij cakun e synuar.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2012, në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte 24,754,402€ ndërsa ajo e planifikuar 28,220,483€ që do të thotë se 88% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është me i vogël për 7% krahasuar vitin 2011 (realizimi: 23,036,867 ndërsa planifikimi 24,434,545).

Kjo nën performancë në vlerë të shitjeve i ka goditur plotësisht KRU sa i përket burimeve financiare që do të ishin të nevojshme për të përmbushur planet e tyre të investimeve




Figura 12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2012 në raport me vitin 2011

Nga Figura 12, vërehet se të gjitha kompanitë kanë shënuar progres në shitjen e ujit gjatë vitit 2012 krahasuar me vitin 2011, nga të cilat prin, KRU “Bifurkacioni” me shitjet me të larta për rreth 15%, si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike në vitin 2012.

Në vlerë absolute shitjet në 2012 në raport me 2011, janë më të larta për 7.5% në nivel të sektorit.

Kostot për njësi

Kostoja e Prodhimit

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar paraqet shpenzimet operative për prodhim të një (1)m³ ujë.




Figura 13, Kostoja për njësi të prodhuar

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2012 nuk ka pësuar ndryshim krahasuar me vitin 2011, d.m.th., ka mbetë e njëjtë me 0.04€/m³.

Kostoja e prodhimit të ujit në të shtatë KRU, është e ndryshme dhe sillet nga ajo më e ulta 0.04 €/m³, tek KRU 'Hidrodrini', deri te ajo më e larta me 0.07 €/m³ në KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Kostoja e prodhimit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga lloji i burimit të furnizimit, (sipërfaqësor apo nëntokësor), dhe mënyra e kaptimit të ujit p.sh kaptimi me gravitet është më i lirë të operohet, se sa sistemi me pompa, mandej burimi i shfrytëzuar me cilësi të mirë dhe sasi të bollshme të ujit të pa përpunuar po ashtu zvogëlon dukshëm koston e prodhimit, siç është rasti i KRU 'Hidrodrini', apo në rastin tek kostoja më lartë e ujit të prodhuar nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', e cila është e ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit në veçanti nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë

Paraqet koston totale duke përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Figura 14, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (duke përjashtuar kthimin në Kapital dhe borxhet e këqija)

Në vitin 2012 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 0.33 EUR/m³, e cila ka pas ngritje shumë të vogël krahasuar me vitin 2011 dhe atë për 0.003 EUR/m³.

Përveç KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Hidrodrini', të cilat në vitin 2012, kanë treguar trende pozitive, në rënje prej 0.02€ (KRU 'Hidrodrini) respektivisht me 0.06 (KRU 'Mitrovica'), të gjitha kompanitë tjera, kanë shënuar trende negative në këtë tregues. Rritja e kostove për njësi të ujit të furnizuar, mund t'i atribuohet rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative të shërbimeve të ujit, përkundër rritjeve të volumit të ujit të shitur.

KRU 'Prishtina', edhe këtë vit vazhdon të jetë me koston me të lartë të furnizimit me ujë me 0.039 EUR/m³, dhe ka shënuar ngritje të koston për 0.004 EUR/m³, krahasuar me vitin 2011.




Figura 15, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2012-2014 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2012), tek shumica e KRU ishin më të ulta se sa ato të planifikuara përjashtuar KRU 'Hidromorava', e cila ka arritur koston e planifikuar për vitin 2012 duke i tejkaluar për 14%, megjithatë kjo nuk tregon efikasitet më të madhe se sa ishte planifikuar, meqenëse kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritje infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja, e që nuk ka arritur ti realizoj as 13% të tyre, si dhe duke i tejkaluar shpenzimet operative për 21%.

Në nivel të sektorit caku i arritur i koston për njësi të furnizimit me ujë ka qenë 74%, rezultatet i të cilës ishin subvencionet (nga Qeveria), për disa KRU, duke zbritur shpenzimet operative që ishin shumë me të larta krahasuar me ato që kishin planifikuar.

Gjatë procesit tarifor (2012-2014), KRU kanë paraparë provizionime të konsiderueshme kapitale të cilat me siguri se do të rezultojnë me përmirësimin e gjendjes së aseteve. Megjithatë shumica e KRU, nuk kanë arritur caqet për koston e planifikuar për shkak të kufizimeve në të ardhura për të bërë shpenzimet e planifikuara në mirëmbajtje dhe përtëritje infrastrukturore të parapara. Kjo detyrimisht do të thotë se do të ketë përkeqësim të gjendjes së aseteve dhe ulje të nivelit të shërbimit.

Shpenzimet kapitale

Ky tregues pasqyron, shpenzimet kapitale aktuale në shërbimin e furnizimit me ujë të ndërmarra nga KRU, në raport me investimet kapitale të planifikuara në procesin tarifor (2012-2014), për vitin 2012.

Shpenzimet kapitale për ujë

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit.




Figura 16, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara (sipas niveleve të çmimeve të mesit të vitit 2012)

Për vitin 2012, KRU kanë paraparë shpenzime të konsiderueshme rreth 32,3 milion €, për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale për shërbime të ujit, këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë

me të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 13,9 milion€ apo 43% nga ajo që ishte planifikuar gjatë procesit tarifor (2012-2014).

Investimet e realizuara kanë vazhduar të jenë kryesisht nga Grantet, (donacionet zhvillimore) pa përjashtuar në të gjitha kompanitë që kapin vlerën prej 12,7 milion€, ndërsa më pak investime janë nga mjetet vetanake gjithsejtë 1,2 milion€.

Nga mjetet vetanake të planifikuara të shpenzohen në vitin 2012, në shërbimin e ujit në shumën prej 7,3 milion€ dhe të cilat janë mbuluar nga tarifatat e aprovuara, janë realizuar vetëm 1,2 milion € apo 17%.

Tabela 1, Shpenzimet Kapitale të KRU, në shërbimin e furnizimit me ujë

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2012				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv.në distribuim	Inv.në aktivitete biznesore	Totali
KRU "Prishtina"	43,517	4,847,628	85,465	4,976,610
KRU "Hidroregjioni Jugor"	948,936	1,903,285	420,271	3,272,492
KRU "Hidrodrini"	9,700	3,076,325	187,066	3,273,091
KRU "Mitrovica"	-	-	20,184	20,184
KRU "Radoniqi"	72,253	181,792	129,610	383,655
KRU "Bifurkacioni"	-	661,456	21,349	682,805
KRU "Hidromorava"	804,477	154,607	357,415	1,316,499
Totali	1,878,883	10,825,093	1,221,360	13,925,336

KRU 'Prishtina', ka realizuar shpenzimet kapitale me të lartat (4,976,610€), nga të gjitha kompanitë e tjera. Me këto shpenzime, është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit me ujë, të përmirësohet shërbyeshmëria e infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të standardeve të shërbimeve (ndërrimin e gypave të ujit, shpërndarjen e rrjetit të ujësjellësit, vendosjen e ujëmatësave.

KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidrodrini', kanë realizuar shpenzime me vlerë të njëjtë. Në KRU 'Hidrodrini', mjetet janë investuar në distribuim dhe atë kryesisht në ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit, ndërtimin e stacionit të pompave, ndërtimin e rezervuarve, furnizim me ujëmatës, etj.

Përderisa, në KRU 'Hidroregjionin jugor', shpenzimet kapitale kanë qenë të orientuara në projektet që lidhen me mirëmbajtjen kapitale, por një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shpenzuar për rritjen e kapitalit.

Kompania e cila ka realizuar më së paku investime në shërbimet e ujit ka qenë KRU 'Mitrovica', me 20,184 ose 0.018% nga ajo e planifikuar. Te kjo kompani janë pritur të bëhen investime të konsiderueshme gjatë periudhës 2012-2014, sidomos në projektet e zgjerimit të kapaciteteve prodhuese si dhe sistemin e tubacioneve të rrjetit shpërndarës.

Ndikimin kryesor për mos përmbushjen e investimeve të planifikuara në lartësin e aprovuar në shumicë, mund ti atribuohet mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit si dhe rritjes së shpenzimeve operative. Duke rezultuar me mungesën e mjeteve aq të nevojshme për investime.

3.2 Shërbimet për ujërat e zeza

Vlerësimi i performancës në ofrimin e shërbimeve të ujërave të zeza, është bërë përmes një numri treguesish po ashtu të ndarë në tri grupe të vlerësimit: performanca teknike, komerciale dhe performanca financiare duke u përqëndruar në performancën e vitit 2012, në raport me vitin 2011, si dhe në raport me nivelin e arritjeve të objektivave të përfshira në procesin tarifor aktual.

3.2.1 Performanca teknike

Në shërbimin e ujërave të e zeza, çështjet më të rëndësishme teknike janë: cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara si dhe besueshmëria e nivelit të shërbimit.

Standardet e shërbimit

Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara

Edhe në vitin 2012, vazhdojmë të mos kemi mundësi të japim informacione për cilësinë e ujërave të zeza të shkarkuara, meqenëse trajtimi i ujërave të zeza praktikisht në Kosovë, ende është në fazën fillestare të ndërtimeve dhe planifikimeve.

Është shumë brengosëse së tërë sasia e ujërave të grumbulluara nga sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i menaxhuar nga KRU, pa kurrfarë trajtimi paraprakë vazhdojnë të hudhen në lumenjë.

Besueshmëria dhe shërbyeshmëria

Besueshmëria e sistemit të shërbimeve të ujërave të zeza është matur në bazë të numrit të incidenteve të raportuara të kolapseve të kanalizimit (që kanë nevojë për renovim/riparim) për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit.




Figura 17, Bllokimet e sistemit të kanalizimit

Gjatë vitit 2012, probleme me bllokimet dhe defektet e sistemit të kanalizimit kanë raportuar të kenë vetëm tri KRU 'Bifurkacionin' 'Hidromorava', dhe 'Prishtina'.

KRU 'Bifurkacioni', paraqitet si kompania me problemet më të mëdha në sistemin e kanalizimit, gjatë vitit 2012, ka pas 26 kolapse për 100 km, gjatësi të rrjetit të kanalizimit.

Në nivel të sektorit norma mesatare e kolapseve për 100 km për vitin 2012 është 8 kolapse.

3.2.2 Performanca komerciale

Në këtë pjesë të raportit ne jemi përqëndruar në aspektet komerciale të ujërave të zeza siç është mbulueshmëria me shërbime dhe ankesat e konsumatorëve në lidhje me shërbimin e kanalizimit.

Mbulueshmëria me shërbime

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujëra të zeza.




Figura 18, Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të zeza

Në përgjithësi shkalla e mbulueshmërisë me shërbimet e kanalizimit gjatë vitit 2012, është në nivelin 56%, në raport me vitin 2011, është më e lartë për 5%.

Përfunduar, KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Radoniqi', të gjitha kompanitë e tjera kanë shënuar trende pozitive në këtë tregues.

Mbulueshmërinë më të lartë me shërbime të ujërave të zeza në zonën e saj të shërbimit e ka realizuar KRU 'Prishtina', dhe në vitin 2012 ka arritur nivelin me 71% duke e rritur mbulueshmërinë e popullatës me këtë shërbim edhe për 7%, në raport me vitin 2011.

Numri i konsumatorëve të cilëve ju ofrohen shërbime të ujërave të zeza, është më i lartë në vitin 2012, mbi 20,000 konsumatorë në raport me vitin 2011, kjo është për një herë me e lartë se sa projeksionet e aprovuara me procesin tarifor i cila ka paraparë rritje të bazës së konsumatorëve për 10,000 konsumatorë për vit.

Në përgjithësi niveli i mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të zeza në vendin tonë, është ende shumë i ulët, dhe nevojat për investime në këtë drejtim janë të mëdha.

Ankesat

Ankesat e konsumatorëve, është një tregues i rëndësishëm i performancës së ofruesve të shërbimeve, numri i ankesave drejtuar në kompani nuk do të thotë domosdoshmërisht performancë e mirë apo e keqe. Është e rëndësishme se konsumatorët më shumë po bëhen të

vetëdijshëm për të drejtat e tyre, prandaj edhe më tepër, janë duke i adresuar ankesat e tyre tek ofruesit e tyre të shërbimit.

Në figurën e më poshtme është paraqitur numri i ankesave në lidhje me shërbimin e ujërave të zeza.




Figura 19, Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza

Gjatë vitit 2012, nga të gjitha KRU, janë raportuar 6,206 ankesa në total për shërbimet e ujërave të zeza e prej të cilave 6,099 kanë të bëjnë me aspektet teknike, ndërsa 107 në ato komerciale. Numri i ankesave gjatë vitit 2012 në total ka shënuar rritje për 2,144, ankesa më tepër se sa në vitin 2011, apo shprehur në përqindje rreth 53% ankesa më shumë. Rritja e ankesave në këtë shërbim është edhe për faktin se KRU në vitin 2012, kanë qenë më të përkushtura në zgjidhjen dhe azhurnimin e ankesave të adresuara nga konsumatorët.

Nga KRU 'Bifurkacioni', nuk është raportuar asnjë ankesë, jo pse në këtë kompani nuk ka probleme në shërbimet e ujërave të zeza, por për faktin se ankesat e konsumatorëve nuk janë azhurnuar si duhet.

3.2.3 Performanca financiare

Kjo pjesë e raportit fokusohet në aspektet financiar⁴ të shërbimeve të kanalizimit të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

Shitjet

Në figurën 20, janë paraqitur vlerat totale të shitjeve për shërbimin e ujërave të zeza në raport me vlerën e vlerësuar të shitjeve sipas planit të bizneseve për periudhën raportuese.

⁴ Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujë të gjitha vlerat e shprehura në euro janë të rregulluara sipas çmimeve bazë të mesit të vitit 2012 për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.




Figura 20, Shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me shitjet e planifikuara

Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, vlera e shitjeve aktuale në shërbimet e ujërave të zeza, gjithashtu është nën vlerat e planifikuara pasi që është drejtpërdrejtë e lidhur me volumet e shitjeve të ujit.

Asnjë nga KRU nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të zeza, gjatë vitit 2012.

KRU 'Radoniqi' ka arritur përqindjen më të lartë, krahasuar me kompanitë e tjera me 96%, Mirëpo, nëse krahasohet me vitin 2011, kjo kompani ka realizuar shitje të shërbimeve të ujërave të zeza më pak për 5%.

Caku i arritur për 2012 në nivel të sektorit është 81%, dhe është me i vogël për 5% nga ajo që ishte në vitin 2011.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të zeza

Nënkupton shpenzimet totale operative, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të zeza në raport me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak për vit.




Figura 21, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza

Në vitin 2012, në nivel të sektorit kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza ka qenë 4.77 EUR/kons. dhe është për 0.04 EUR/kons, më e lartë krahasuar me vitin 2011.

Përveç KRU “Mitrovica” dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” të cilat në vitin 2012, kanë treguar trende negative me një ngritje prej 3.42€ (Mitrovica) dhe 0.26 (Hidroregjini Jugor), të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar trende pozitive në këtë tregues.

Rritja e kostove për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza mund t’i atribuohet rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative dhe shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale për shërbimet e ujërave të zeza, e në veçanti të rritjes së shpenzimeve për trajtimin e ujërave të zeza të cilat edhe kanë ndikuar në rritjen e lartë të kostos të KRU ‘Mitrovica’.

Koston më të ulët në këtë tregues e ka KRU ‘Prishtina’, 2.88 EUR/kons e cila përkundër ngritjes së shpenzimeve totale për shërbimet e ujërave të zeza ka pasur përmirësim për 0.08 EUR/kons krahasuar me vitin 2011.

Mëqenëse nuk janë futur ende në përdorim impiantet për trajtimin e ujërave të zeza kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza mbesin shumë me të ulëta krahasuar me kostot e furnizimit me ujë.

Shpenzimet kapitale për ujëra të zeza

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit.




Figura 22, Shpenzimet kapitale për shërbime të ujërave të zeza në raport me ato të planifikuara (sipas niveleve të çmimeve të mesit të vitit 2012)

Sikurse të shërbimet me furnizim me ujë, kompanitë për vitin 2012, kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 10,9 milion € për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza, të parapara të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 1,5 milion ose 14% nga ajo që ishte planifikuar.

Është evidente se shumica e investimeve të realizuara janë nga donacionet prej 1,464,031€, ndërsa pjesa tjetër është nga të hyrat vetanake gjithësejtë 38,463€ .

Nga mjetet vetanake të planifikuara të shpenzohen në shërbimin e ujërave të zeza në shumë prej 1,5 milion € dhe të cilat janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, janë realizuar vetëm 38,463€ apo 17%.

Tabela 2, Vlerat e shpenzimeve kapitale në shërbimin e ujërave të zeza

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të zeza nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2012					
Kompania	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
KRU "Prishtina"	12,456	-	-	2,643	15,099
KRU "Hidroregjioni Jugor"	-	-	-	57,310	57,310
KRU "Hidrodrini"	1,377,806	-	-	9,846	1,387,652
KRU "Mitrovica"	-	-	-	1,288	1,288
KRU "Radoniqi"	-	-	-	6,822	6,822
KRU "Bifurkacioni"	4,782	-	-	2,639	7,421
KRU "Hidromorava"	-	-	-	26,902	26,902
Totali	1,395,044	-	-	107,450	1,502,494

Sa i përket investimeve në shërbimet e ujërave të zeza prin KRU 'Hidrodrini' me 30%, të shumës totale të investimeve (4,660,743), të cilat kryesisht kanë qenë në ndërtimin e gypave, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimin e kolektorit për ujëra të zeza në Istog, gjë që shumica e KRU e tjera nuk kanë arritur që as 2% të vlerës totale të investimeve të investojnë në shërbimin e ujërave të zeza.

Përpos KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Hidromorava' të cilat kanë realizuar investimet e planifikuara ne nivelin 61%, përkatësisht 23% , kompanitë e tjera kanë pasur investime shumë të vogla në shërbimet e ujërave të zeza për vitin 2012.

Sidomos kjo është brengosëse për KRU 'Prishtina' e cila ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të zeza e prej të cilave janë realizuar vetem 0.6%.

3.3 Performanca e përgjithshme financiare KRU

Arkëtimi i të ardhurave

Në vitin 2012, shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujit dhe të ujërave të zeza si mesatare e sektorit është 70% dhe shënon ngritje në raport me vitin 2011, për 1%.




Figura 23, Efiçenca në arkëtimin e të ardhurave

Siç ilustron edhe nga Figura 11 në vitin 2012, progresin më të mirë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Radoniqi' me 78%, ndërsa performancën më të ulët në shkallën e arkëtimit e ka realizuar KRU 'Mitrovica' me vetëm 50%.

Përveç KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Prishtina' të cilat në vitin 2012, kanë pasur rritje të shkallës së arkëtimit prej 6%, KRU 'Radoniqi', përkatësisht 4% KRU 'Prishtina', të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar trende negative në këtë tregues, përkundër KRU 'Hidroregjioni Jugor' e cila ka mbetë në nivel të njëjtë me 72% krahasuar me vitin 2011.

Masat e ndërmarra nga disa KRU kryesisht kanë qenë të fokusuar në shkyçje të konsumatorëve nga shërbimi i furnizimit me ujë, riprogramimi i borxheve, stimulimi por edhe ndëshkimi i zyrtarëve përgjegjës.

Reduktimi i shkallës së arkëtimit, reflekton një keqësim të dukshëm për mbledhjen e të hyrave të gatshme në KRU (Mitrovica, Hidrodrini, Bifurkacioni dhe Hidromoraven)

Tabela 3, Performanca aktuale dhe e planifikuar e arkëtimit të të ardhurave për vitin 2012

Kategoria e Konsumatorëve	KRU Prishtina		KRU Hidroregjioni Jugor		KRU-Hidrodrini		KRU Mitrovica		KRU Radoniqi		KRU Bifurkacioni		KRU Hidromorava	
	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.
Amvisëri	63%	63%	63%	64%	47%	63%	39%	49%	79%	74%	57%	67%	71%	74%
Komercial-Industrial	87%	93%	74%	79%	59%	82%	67%	89%	64%	75%	58%	61%	70%	88%
Institucione	106%	99%	105%	91%	97%	98%	102%	97%	92%	94%	59%	90%	97%	94%
Totali	75%	75%	72%	73%	57%	72%	50%	63%	78%	76%	58%	68%	74%	79%

Gjatë procesit tarifor 2012-2014, ne kemi qenë më të kujdesshëm në qasjen tonë për të përcaktuar caqet reale, por megjithatë sfiduese, në lidhje me objektivat për performancën e ardhshme në arkëtimin e të ardhurave. Caku i planifikuar për 2012 në nivel të sektorit ka qenë 73%, përderisa aktualisht në nivel të sektorit ka mundur të arkëtohen vetëm 70% të shumës së faturuar. Shkalla aktuale e arkëtimit të të ardhurave në nivel të sektorit ka paraqitur devijim prej 3%, kundrejt planit.

Në rritjen e shkallës së arkëtimit prej 70% në nivel të sektorit kryesisht ka ndikuar arkëtimi i të ardhurave nga institucionet duke tejkaluar cakun e planifikuar për 6% (realizimi 102%, planifikimi 96%), gjë që të dy kategoritë tjera nuk kanë arritur as ti përafrohen objektivave të tyre.

Shumica e KRU-ve, kanë dështuar në përmbushjen e objektivit të caktuar individual, me përjashtim të KRU 'Prishtina' e cila ka arritur nivelin e arkëtimit të planifikuar dhe KRU 'Radoniqi' e cila ka tejkaluar arkëtimit e planifikuar për 2 %.

Dështimi për të arritur objektivat e rritjes dhe arkëtimit e të ardhurave ka rezultuar me të ardhura më të ulëta se ato që ishin planifikuar dhe në këtë mënyrë kanë penguar në një masë aftësinë e KRU për të përmbushur detyrimet e tyre në lidhje me investimet kapitale.

Kthimi në kapital

Paraqet ndryshimin në mes të të ardhurave vjetore, shpenzimeve operative, mirëmbajtjes kapitale dhe të ardhurave të shlyera të cilat rrinë në raport me bazën rregullatore të aseteve (BRA).

Kthimi në kapital është i nevojshëm për të siguruar besimin e investitorëve në sektorë, nëse KRU duan që të tërheqin financime për përmirësimin e aseteve në mënyrë që të përmbushin përmirësimin e nevojshëm të nivelit të shërbimit.

Baza rregullatore e aseteve (BRA) mbi të cilën është përcaktuar kthimi në kapital, është përcaktuar në vitin 2008 që nga procesi tarifor (2009-2011), ka filluar me 1 Janar 2009 me bazën rregullatore të aseteve (BRA) për secilën prej kompanive të ujit, duke përdorur vlerën e përcaktuar të aseteve prej 200€ për konsumatorët e shërbimit të furnizimit me ujë dhe 100€ për konsumatorët e ujërave të zeza.

Norma reale e kthimit në kapital është e bazuar në praktikat e mira të vëndeve të Evropës Perëndimore, dhe tek ne për procesin tarifor (2012-2014), kemi llogaritur që kjo të jetë 5.30% si shumë e kalkuluar para normës së inflacionit.




Figura 24, Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRA)

Siç vërehet edhe nga figura të gjitha kompanitë në vitin 2012 kanë pasur kthime pozitive, vlerat e të cilave sillen nga 1.68% tek KRU 'Hidroregjioni Jugor' në 4.61% të KRU 'Hidrodrini', e që nuk ishin shumë më të ulëta se kthimi i planifikuar.

Nga kjo mund të themi se të gjitha kompanitë në vitin 2012, kanë arritur të mbajnë shpenzimet e tyre (duke përfshirë përtëritjen dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale në bazën rregullatore të aseteve) brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

3.4.1 Arsyeshmëria

Qëllimi i ZRRUK, është për të ndihmuar dhe rregulluar KRU në Kosovë, në mënyrën që përmes një procesi të vazhdueshëm të përmirësimit performancës dhe të ndikojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënjes për, dhe nga ky sektor. Për këtë ne kemi zhvilluar një program kombëtar të Monitorimit dhe të Vlerësimit të Performancës (Benchmarking), i bazuar në përvajtjet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare për shërbimet e ujit.

ZRRUK pra, ka zhvilluar një model të vlerësimit të performancës për ujë dhe ujërave të zeza, i bazuar në një sistem të treguesve (indikatoreve) i cili analizon të gjitha fushat kyçe të performancës të rëndësishme për konsumatorin dhe ofruesin e shërbimeve si në: cilësinë e ujit, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit, efikasitetin të kostove dhe financave, në mënyrë që të tregojnë një pamje të balancuar në performancën e operatorëve të shërbimeve të ujit i cili ka në fokus përfitimet për konsumatorin.

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues është një instrument menaxhimi për të provuar përmirësimin e performancës nëpërmjet kërkimit sistematik dhe adaptimit të praktikave udhëheqëse. Ky nuk është një veprim i vetëm, por i vazhdueshëm, proces ciklik që përbëhet nga dy hapa të njëpasnjëshëm: (i) Vlerësimi i performancës dhe (ii) Përmirësimi i performancës. KRU, veprimet në kushte të monopolit të plotë në zonat e tyre respektive të shërbimit, dhe përdorimi i vlerësimit krahasues është i nevojshëm për: të nxitur konkurrencën, të përcaktojë progresin e bërë në këtë sektor dhe të lejojë palët e ndryshme për të planifikuar ndërhyrjet e duhura. Në këtë mënyrë çdo KRU është e motivuar për të përmirësuar performancën e saj në raport me atë të mëparshmen, si dhe të bëjë punën e saj më mirë se kompanitë e tjera si motra.

3.4.2 Vlerësimi i performancës

Në vazhdim ne kemi analizuar performancën e KRU, për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2012, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti paraprakë (2011) në: (i) Ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, (ii) Shërbime të ujërave të zeza, si dhe (iii) Performancën financiare.

Ne po ashtu kemi bërë rangimin e kompanive në bazë të rezultateve të arritura në treguesit kryesor korrespondues për fushën përkatëse duke e krahasuar me performancën e synuar ideale. Njëmbëdhjetë (11) treguesit kryesor të performancës(TKP)⁵, të analizuar në mënyrë më specifike, janë rezultat i të dhënave të raportuara si dhe janë të ndikueshme nga shumica e treguesve të tjerë të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë apo të tërëdhortë. Këta tregues pra, janë të rëndësishëm, janë në mundësinë e menaxhmentit të kompanive të ujit për të përmirësuar si dhe japin një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve.

⁵ Tabela 10, Struktura e matjes së performancës

Shërbimet e furnizimit me ujë

Në këtë pjesë, ne kemi analizuar performancën e KRU në ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe i kemi ranguar kompanitë në bazë të rezultateve të arritura në vitin 2012, në sëcilin prej 5 (pesë) treguesve kryesor të këtij shërbimi siç janë: cilësia e ujit, presioni, vazhdimësia e furnizimit, mbulueshmëria me shërbime si dhe efienca e kostove.

Vlerësimi i performancës së furnizimit me ujë, bazohet në performancën krahasuese me nivelin ideal të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim efikas me ujë.




Figura 25, Përfomanca e përgjithshme e shërbimit të furnizimit me ujë (2011- 2012)

Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujë në vitin 2012, ka arritur nivelin 37.8% nga performanca ideale e cila ka maksimalen prej 45% dhe është më e përmirësuar se sa në vitin 2011, për 3.8%. Përmirësim është shënuar nga të gjitha KRU, përjashtuar KRU 'Mitrovica'. Përmirësimi është evident në të gjitha fushat e matjës së performancës. Fushat në të cilat është shënuar performancë më e mirë janë efienca e kostove, vazhdimësia e furnizimit si dhe mbulueshmëria me shërbimet e ujës jellësit. Me pak përmirësime janë evidentuar tek cilësia e ujit dhe presioni, kjo është edhe për faktin se këto dy fusha kanë pak hapësirë të përmirësimit mëqenëse ato janë në nivele të larta të përmbushjes së tyre.

Përmirësimin më të lartë në 2012, në raport me 2011, e kanë shënuar KRU 'Prishtina', me 11.5%, KRU 'Hidroregjioni Jugor', me 6.4%, si dhe KRU 'Bifurkacioni', me 4.0%.

KRU 'Prishtina', përmirësime ka shënuar tek vazhdimësia e furnizimit si dhe në koston e efiençës, përderisa pak përmirësime ka pasur edhe tek mbulueshmëria me shërbime.

Në, KRU 'Hidroregjioni Jugor', janë shënuar përmirësime tek vazhdimësia e furnizimit me ujë , presioni, kualiteti i ujit si dhe të mbulueshmëria me shërbime.

KRU 'Hidrodrini', vazhdon të jetë kompania me performancën më të mirë në furnizimin me ujë. Performanca aktuale e saj është në nivelin 44%, të performancës ideale, të pasuara nga KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', të cilat po ashtu kanë shënuar përmirësime në këtë shërbim.

Performancën më të dobët në furnizim me ujë e kanë KRU 'Mitrovica', dhe KRU 'Bifurkacioni'. Sidomos në pozitë të vështirë është KRU 'Mitrovica' e cila vazhdon të këtë ende, vështirësi të mëdha, me vazhdimësinë e furnizimit me ujë, dhe mbulueshmërinë e zonës me shërbime.

Shërbimet për ujërat e zeza

Në shërbimin e ujërave të zeza (kanalizim dhe trajtim i ujërave të zeza), është planifikuar të bëhet monitorimi i performancës në 4 (katër) fusha siç janë: (i) Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara, (ii) Besueshmëria e shërbimit, (iii) Mbulueshmëria me shërbime, (iv) dhe Efiçencën e kostos. Meqenëse aktualisht trajtimi i ujërave të zeza në Kosovë, është në fazat fillestare në kemi pasur mundësi që KRU ti monitorojmë dhe vlerësojmë, vetëm në shërbimin e kanalizimit dhe atë në dy tregues: (i) Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit dhe (ii) Efiçencën e kosotos.




Figura 26, Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza (2011- 2012)

Performanca e shërbimit të ujërave të zeza, ka shënuar pak përmirësime (0.8%) në vitin 2012 në raport me vitin 2011. Kryesisht përmirësimi ndërlidhet me zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime, e cila në përgjithësi në nivel të sektorit është përmirësuar për 2,3%. Në nivel të sektorit performanca e përgjithëshme e KRU në këtë shërbim është vetëm 12.8%, dhe në raport me performancën ideale (e cila është vlerësuar me maksimalen e mundshme me 35%), të synuar në këtë shërbim, është shumë e ultë. Ne presim që në vitet në vijim në këtë shërbim do të këtë investime me të konsiderueshme, një pjesë e tyre tanimë është planifikuar të bëhen në fushën e trajtimit të ujërave të zeza.

Performanca e përgjithshme e KRU

Performanca e përgjithshme, nënkupton performancën e KRU, për të dy shërbimet atë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza, e kombinuar me performancën financiare gjegjësishtë, profitabilitetin dhe efijencën komerciale.

Tabela 4, Tabela e rezultateve për 2011

KRU	Furnizim me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%
GJA	41.3%	12.3%	0.0%	2.8%	56.4%
PE	43.0%	9.9%	1.6%	0.4%	55.0%
GJI	35.4%	11.0%	0.0%	4.5%	50.8%
FE	30.6%	14.0%	0.4%	0.7%	45.7%
PZ	29.8%	11.0%	1.4%	3.1%	45.2%
PR	25.8%	14.7%	0.0%	2.7%	43.2%
MIT	32.0%	11.0%	0.0%	0.0%	43.0%
Totali i pikëve	34.0%	12.0%	0.5%	2.0%	48.5%

Tabela 5, Tabela e rezultateve për 2012

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve	Ndryshimi ⁶ 2011/2012
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%	
PE	44.0%	10.7%	8.7%	0.0%	63.5%	+8.5%
PR	37.3%	16.0%	6.2%	3.8%	63.3%	+20.1%
GJA	40.5%	12.2%	5.5%	4.4%	62.7%	+6.3%
PZ	40.3%	13.3%	3.2%	2.9%	59.7%	+14.5%
GJI	36.6%	10.9%	7.2%	3.5%	58.2%	+7.4%
FE	34.8%	14.8%	8.3%	0.0%	57.9%	+12.2%
MIT	31.1%	11.3%	3.3%	0.0%	45.7%	+2.7%
Totali i pikëve	37.8%	12.8%	6.1%	2.1%	58.7%	
Ndryshimi ⁷2012/2011	+3.8%	+0.8%	+5.6%	+0.1%	+10.2%	

Tabelat 4 dhe 5, Rezultatet e vlerësimit të performancës, sipas kategorive dhe sipas kompanive, për dy vite (2011&2012).

Performanca e përgjithshme e KRU, në vitin 2012 ka arritur nivelin 58.7%, në raport me performancën e synuar ideale dhe është më e përmirësuar për 10.2%. në raport me vitin 2011. kur ajo ishte vetëm 48,5%. Përmirësimi është evident në të dyja shërbimet (furnizim me ujë 3.8%, dhe shërbime të ujërave të zeza, 0.8%), sidomos përmirësimi është më i theksuar tek performanca financiare gjegjësishtë profitabiliteti më 5.6% dhe vetëm 0.1%, është përmirësuar shkalla e arkëtimit.

Furnizimi me ujë ka arritur në shkallën 37,8% nga maksimalja prej 45%, përmirësimi është për 3.8%, në raport më një vit me parë.

⁶ Arritjet e performancës së, KRU në vitin 2012 në raport me vitin 2011.

⁷ Arritjet e performancës sipas grupeve të vlerësimit, në vitin 2012 në raport me vitin 2011.

Performanca e shërbimeve të ujërave të zeza është dukshëm më e ulët se ajo e furnizimit me ujë. Në vitin 2012, është arritur niveli 12.8%, nga maksimalja e mundshme prej 35%, duke shënuar shumë pak përmirësime vetëm për 0.8%.

Profitabiliteti paraqet kthimin aktual në bazën rregullatore të aseteve në raport me kthimin në kapital të projektuar, përmes procesit tarifor (2012-2014). Në këtë drejtim KRU, kanë pasur një përmirësim evident edhe pse kjo është më e ulët se ajo që është planifikuar, prej 5.3%. Shkalla e profitabilitetit në mesatare të sektorit ka arritur nivelin prej 6.1%, në 2012 nga maksimalja prej 10% dhe në krahasim më vitin 2011, është më e përmirësuar për 5.6%.

Përderisa në vitin 2011, vetëm tri KRU (Hidroregjioni jugor, Hidrodrini dhe Bifurkacioni, kanë qenë pak profitabile. Në vitin 2012, të gjitha kompanitë pa përjashtim kanë qenë profitabile,(d.m.th. me qarkullimin financiar, KRU kanë arritur ti mbulojnë shpenzimet operative dhe mirëmbajtjen e kapitalit duke përjashtuar edhe provizionimin e borxheve të këqija). KRU 'Hidrodrini', 'Bifurkacioni' , 'Hidromorava' por edhe KRU 'Prishtina', kanë qenë në nivele të konsiderueshme profitabile.

Efiçenca e arkëtimit, është një fushë e cila lenë shumë për tu dëshiruar. edhe pse vit pas viti është duke shënuar përmirësim, ai është shumë i ngadalshëm. Progresi po tregohet të jetë shumë i vështirë, sidomos mbetet sfida, përmirësimi i arkëtimit të konsumatorët e amvisëris dhe të bizneseve.

Në këtë vit po ashtu është shënuar përmirësim modest me vetëm 1%, në raport me vitin paraprak, shkalla mesatare e sektorit në vitin 2012, ka shënuar nivelin 70%. Përmirësime në këtë tregues kanë shënuar KRU 'Radoniqi', duke fituar 4.4 (%) respektivisht KRU 'Prishtina' duke fituar 3.8% të pikëve nga maksimalja e mundshme prej 10 %, të përcaktuar për këtë nën grup. Pragun më të ulët prej 60%, po ashtu kanë arritur ta kalojnë KRU 'Hidromorava' dhe 'Hidroregjioni Jugor', ndonëse këtë vit, performanca e tyre në efiçencën komerciale është me e dobët se sa ajo që ishte në vitin 2011.

KRU 'Hidrodrini', 'Bifurkacioni' si dhe 'Mitrovica', kanë performancën me të dobët në efiçencën e arkëtimit. Janë, tri kompani të cilat nuk kanë mundur të tejkalojnë cakun e me të ulët prej 60%, duke mos e siguruar asnjë pikë në këtë tregues.

Në vitin 2012, performanca e të gjitha KRU, ka qenë me e përmirësuar se sa në vitin 2011. Përmirësimin më të lartë e kanë shënuar KRU 'Prishtina', Bifurkacioni, Hidroregjioni jugor' 'Hidrodrini' dhe 'Radoniqi', përdërisa me pak përmirësim kanë shënuar KRU 'Mitrovica' dhe 'Hidromorava'.

Performanca e Përgjithshme e KRU




Figura 27, Performanca e përgjithshme e KRU (2011 & 2012)

Në figuren 27, është pasqyruar, rangimi i KRU sipas performancës së tyre për vitet 2011-2012, dhe në raport me kompaninë Ideale.

Në përgjithësi kompania me performancën më të mirë në vitin 2012, e ka KRU 'Hidrodrini', duke arritur nivelin prej 63.5% nga maksimalja prej 100%, të cilin nivel e kanë ofruesit me performancën e përvetësuar ideale, performanca e KRU 'Hidrodrini', është përmirësuar më mbi 8.5%, nga viti i kaluar.

KRU 'Prishtina', është në pozitën e tretë, kjo kompani ka shënuar përmirësimin më të lartë nga të gjitha kompanitë e tjera 20% në raport me vitin 2011.

KRU 'Mitrovica' edhe përkundër disa përmirësimeve në këtë vit ka performancën me të dobët nga të gjitha kompanitë. Vlenë të theksohet se kjo kompani është në pozitë të vështirë për shkak të problemeve politike në këtë rajon, siç është pjesa veriore e Mitrovicës, minoritetet serbe dhe rome, nga të cilat nuk merr kompensim adekuat për shërbimin e ofruar.

Në përgjithësi, KRU në vitin 2012, kanë një diferencë të ngushtë në performancën e tyre, përjashtuar KRU 'Mitrovica' e cila ka një dallim rreth 18% nga KRU 'Hidrodrini' e ranguar si e para.

Diferencë shumë e ngushtë në performancën e tyre të përgjithshme është në mes të, KRU 'Hidrodrini', 'Prishtina' dhe 'Radoniqi', më me pak së 1%.

Pjesa B:

Performanca e Sektorit të Shërbimeve të Ujësjetës-Kanalizimit

4 PERFORMANCA E SEKTORIT

Më herët në këtë raport kemi shqyrtuar dhe analizuar secilin tregues veçmas duke dhënë informacione për nivelin e tyre për çdo KRU, dhe tani ne vazhdim do të japim një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës së përbashkët për të gjitha KRU, në disa prej treguesve të cilët reflektojnë në performancën e sektorit.

Performanca e sektorit është dhënë duke përdorur disa të dhëna statistikore dhe tregues, për një periudhë kohore 4 vjeçare (2009-2012).

Ky vlerësim i performancës së sektorit, bëhet me qëllim të dhënjes së një pasqyre sa më të qartë të trendeve të zhvillimit të sektorit në përgjithësi.

Vlerësimi i performancës së përgjithshme për këtë sektor është bërë përmes; mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit, prodhimit të ujit të pijshëm, ujit të pafaturuar (UPF), eficientës së faturimit dhe arkëtimit, si dhe janë dhënë informacione për shumatat e investimeve kapitale.

4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF

Në Figurën 26, është paraqitur UPF në funksion të prodhimit të ujit dhe ujit të shitur (faturuar). UPF, është sasia e ujit të prodhuar (distribuar), duke zbritur sasinë e ujit që është shitur gjegjësisht që është faturuar për konsumatorët.




Figura 28, Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Prodhimi i ujit nga 7 (shtatë) KRU, gjatë viteve 2009-2011 ka shënuar rritje të arsyeshme gjithnjë duke pasur parasysh rritjen e bazës së konsumatorëve vit pas viti, megjithatë në vitin 2012, është raportuar rënje e prodhimit të ujit dhe kjo është ndikuar sidomos nga KRU 'Radoniqi dhe 'Bifurkacioni, përderisa nga KRU 'Radoniqi' rënja e prodhimit është si rezultat i vlerësimit të prodhimit në mungesë të funksionalitetit të ujëmatësit të prodhimit të ujit, me q'rastë është raportuar një sasi me e ulët në raport me vitin 2011. Po ashtu me pak ujë është prodhuar edhe nga KRU 'Bifurkacioni' për shkak të mungesës së ujit në burime. Në përgjithësi gjatë vitit 2012, nga shtatë KRU janë prodhur dhe distribuar tek konsumatorët mbi 138 milion m³ ujë të pijshëm dhe është për rreth 8 milion m³ me pak së në vitin 2011. Shitja e ujit gjatë

vitit 2012 sillet rreth 58 milion m³ dhe është mbi 1.3 milion m³, uji i faturuar me tepër së në vitin 2012.

Faturimi i ujit gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare, ka shënuar një përmirësim shumë të vogël.

Analizat e bëra tregojnë se UPF në Kosovë, është 58% e sasisë totale të furnizuar apo në sasi kjo vlerë është 80 milion m³. Nëse kjo shifër është shumëzuar me çmimin e një metër kub ujë, që në Kosovë mesatarja është 0,31€ për konsumatorët e amvisërisë, kjo do të thotë se humbjen e ujit shkaktojnë me së paku rreth 25 milion Euro, humbje financiare vjetore për kompanitë tona. Ne jemi të bindur se mbi 50% e UPF, është humbje komerciale e cila shkaktohet nga keqpërdorimet e ujit prej qytetarëve përmes lidhjeve ilegale por edhe hargjimeve enorme nga konsumatorët të cilët faturohen në mënyrë paushalle.

Ne i inkurajojmë KRU që të bëjnë shumë më tepër se sa ato janë duke bërë për momentin sa i përket reduktimit të UPF dhe në këtë mënyrë të rrisin të ardhurat e tyre si dhe të sigurojnë sasi më të madhe të ujit për ato zona që vuajnë nga kufizimet e ujit.

4.2 Mbulueshmëria me shërbime

Çdo KRU në Kosovë, është e licensuar për të operuar në një zonë të caktuar të shërbimit e cila është në përputhje me planin e konsolidimit të sektorit. Në përputhje me këtë, janë parapar edhe shtatë zonat e shërbimit. Popullsia e cila shërbehet në zonat operuese të shtatë KRU vlerësohet të jetë mbi 1.2 milion banorë nga 1.6 milion sa janë në total. Kjo është llogaritur në bazë të raporteve nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, në kombinim me të dhënat e kompanive për numrin e konsumatorëve të shërbyer.




Figura 29, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit

Mbulueshmëria më shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit e shprehur si përqindje e konsumatorëve shtëpiak në raport me popullatën në zonën e shërbimit të KRU është e paraqitur në figuren 29.

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit në vazhdimësi që nga viti 2009 ka pasur ngritje kontinuale. Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit në vitin 2012, ka arritur nivelin prej 78% dhe në krahasim më vitin 2009, është shënuar përmirësim për 13%. Po ashtu

edhe mbulueshmëria me kanalizim ka shënuar trend pozitiv, ku gjatë vitit 2012 ka arritur vlerën prej 56% ku në raport me vitin 2012 ka pas rritje për 5%.

Progresi në mbulueshmërinë me shërbime gjatë kësaj periudhe, kryesisht mund ti atribuohet donatoreve ndonëse një pjesëmarrje e konsiderueshme është ofruar nga KRU dhe komunat respektive.

Ne i kemi marrë parasyshë projeksionet e KRU, me procesin e zhvilluar tarifor (2012-2014), që të përshpejtojnë planet e tyre për zgjerimin e zonës së mbulueshmërisë me shërbime duke e parë këtë jo vetëm si interes për konsumatorët por si të dobishme edhe për vetë KRU, kjo si rezultat i të hyrave shtesë që mund të sjellin konsumatorët e rinjë.

Numri total i konsumatorëve shtëpiak në vitin 2012, në raport me vitin 2011, në shërbime të furnizimit me ujë është rritur, për 10,781. përdërisa numri i konsumatorëve shtëpiak në shërbime të kanalizimit është rritur për 19,508 duke i tejkaluar planifikimet e projektuara të cilat kanë qenë që gjatë, këtyre tri viteve, baza e konsumatorëve të rritet çdo vit nga 10,000 konsumtorë, në furnizim me ujë dhe konsumatorë në shërbime të kanalizimit.

4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Qarkullimi nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujit dhe ujërave të zeza.




Figura 30, Performanca financiare e sektorit (nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2011)

Figura, 30, tregon efikasitetin mesatar të qarkullimit dhe inkasimit gjatë 4 viteve, dhe jep një pasqyrë me të qartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.

Planifikimet në përgjithësi të KRU, në lidhje me qarkullimin dhe arkëtimin në vlera monetare gjatë procesit tarifor (2009-2011), kanë qenë mjaft ambicioze për tu arritur, përdërisa të arkëtimit i keshit ka shënuar trende graduale në rritje por të qëndrueshme. Qarkullimi aktual ka qenë i paqëndrueshëm gjatë viteve edhe përkundër asaj se gjatë procesit tarifor (2009-2011) ka pasur ngritje të tarifave.

Edhe pse ZRRUK gjatë procesit tarifor (2012-2014) ka qenë me i kujdesshëm se sa që ishte në procesin e kaluar (2009-2011) gjatë përcaktimit të objektivave, të cilat do të jenë realisht të arritshme por njëkohësisht edhe sfiduse. Ne me keqardhje konstatojmë se objektivat e planifikuara e sidomos ato në lidhje me faturimin, arkëtimin, nuk kanë mundur të arrihen, prandaj performanca aktuale në vitin 2012, ishte nën nivelin e pritur. Kjo kishte ndikime të mëdha në qarkullimin e parasë së gatshme e që rrjedhimisht ka kufizuar seriozisht KRU që të zbatojnë programet e tyre të planifikuara për investime dhe të sigurojnë një kthim të projektuar në kapitalë.

Në përgjithësi KRU, janë duke përmirësuar efikasitetin e qarkullimit dhe arkëtimin vit pas viti, si në vlerë monetare ashtu edhe në përqindje (%). Vlenë të përmendet se edhe pse përmirësimi është gradual me rëndësi të veçantë është se ai është i qëndrueshëm.

Qarkullimi (faturimi) në vitin 2012, në vlerë monetare është përmirësuar për 5,313,454 €, në raport me vitin 2009, apo shprehur në 23% në raport me vitin 2009. Ky përmirësim më shumë i atribuohet ngritjes së tarifave, zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vit pas viti e më pak ngritjes së efikasitetit të faturimit të konsumatorëve për ujin e konsumuar.

Keshi i arkëtuar, në vlerë monetare në nivel sektori po ashtu gjatë vitit 2012, ka shënuar përmirësim për 5,458,445 € apo shprehur në përqindje për 37% në raport me vitin 2009.

Shkalla e arkëtimin në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2012 ishte 70% apo 7%, më i lartë se në vitin 2009.

4.4 Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza

Ky seksion, paraqet analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifor (2009-2011), i cili ka përfunduar dhe vitit të parë (2012) i procesit aktual tarifor (2012-2014).

Është e qartë se financimi drejt sektorit është një detyrë madhore e që ka nevojë për përpjekje të bashkërenduara nga aktorë të ndryshëm. Përderisa ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime.

